



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 4262/Prot.

Tiranë, më 21/3/2013

Lënda: Urdhër për Kontrolluesin klinika mjekësore "3 yjet" Tiranë.

U R D H Ë R
Nr 10, datë 21/03/2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "*Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "*Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të Kontrolluesit klinika mjekësore "3 yjet" Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të urdhërit nr.7 datë 08/01/2013 është ushtruar inspektimi administrativ pranë Kontrolluesit klinika mjekësore "3 yjet" Tiranë, bazuar në ankesën e datës 24.11.2012 të shtetasit A.B lidhur me monitorimin me anë të sistemit të kamerave, të rrugës publike ku ai banon. Inspektimi administrativ kishte për objekt:

- Verifikimi i ankesës së shtetasit A.B drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e cila lidhet me monitorimin me anë të sistemit të kamerave, të rrugës publike ku ai banon.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ, pretendimet e kontrolluesit si dhe provat e administruara dhe vëren se:

Kontrolluesi, klinika mjekësore "3 yjet" ka instaluar dhe përdor për mbikëqyrje dhe regjistrim sistemin e "*Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi*" në ambientet e tij ku përfshihen, ambiente të pritjes së pacienteve, hyrja, shkallët, si dhe pamje jashtë ambienteve të objektit (*një në portën hyrëse dhe një nga ana e dritareve në krahun tjetër të objektit*). Qëllimi i përdorimit të sistemit të "*Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi*", i cili kryen përpunim e imazheve të cilat janë të dhëna personale me karakter të veçantë fizik është "*siguria e ambienteve të kontrolluesit nga dëmtimet, siguria e punonjësve dhe pacientëve*".

Janë të instaluar 8-kamera nga të cilat aktualisht funksionojnë vetëm 5 prej tyre. Kamerat janë fikse, 4 prej tyre monitorojnë ambientet e brendshme të godinës. Kamera që monitoron hyrjen kryesore të Kontrolluesit është e vendosur në një kënd i cili nuk merr pamje nga ambientet e ndërtesave përballë saj, ajo monitoron deri në një largësi 3 metra nga porta e saj e hyrjes. Kamera tjetër e cila është e montuar në anën tjetër të godine në momentin e

kryerjes së inspektimit administrativ nuk ishte në punë dhe nuk u morën foto të pamjeve që ajo merr.

Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, vlerëson se përdorimi i sistemit të *“Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi”* në këto ambiente duhet të respektojë jetën private të punonjësve dhe pacienteve, në përputhje me Konventën Evropiane për *“Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut”*, si dhe ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar.

1. Kontrolluesi nuk ka njoftuar pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me anë të formularit të njoftimit, lidhur me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale përmes përdorimit të sistemit të *“Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi”*, duke shkelur nenin 21 pikë 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar... *“Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”*.

Kontrolluesi ka vendosur në ambientet e jashtme një kamera që është e montuar në anën tjetër të godinës e cila në momentin e kryerjes së inspektimit administrativ nuk ishte në punë dhe nuk mund të shihet se cilat janë pamjet që ajo regjistron. Në këto kushte, kur nuk është në funksionim, si dhe duke mos pasur pamjet që merren nga kjo kamera nuk mund të vërtetohet nëse funksionon për qëllimin për të cilin ka deklaruar Kontrolluesi, kjo kamer duhet të hiqet. Në rast se kontrolluesi vendos të montojë përsëri kamer, atëherë ai duhet të njoftojë menjëherë Komisionerin dhe kamera duhet të montohet në mënyre të tillë që të jetë drejtuar vetëm drejt fasadës së godinës të Kontrolluesit dhe të mos marrë pamje nga rruga, objektet dhe hapësirat pranë saj.

2. Kontrolluesi nuk ka vendosur tabela informuese për informimin e subjekteve që i nënshtrohen vëzhgimit dhe regjistrimit përmes përdorimit të sistemit të *“Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi”*, duke shkelur nenin 18 pikën 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar... *“Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij”*, si dhe Udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale *“Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*. Modeli i tabelës mund të shkarkohet nga faqja zyrtare e Komisionerit në internet (www.kmdp.al).

3. Kontrolluesit nuk ka një rregullore të shkruar për përdorimin e sistemit të *“Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi”* duke shkelur, nenin 27 pikën 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar... *“Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi”*, si dhe Udhëzimin nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale *“Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

U R D H Ë R O J

1. Në zbatim të nenit 21, pika 1 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të njoftohet pranë Komisionerit me anën e "formularit të njoftimit" përpunimi i të dhënave personale përmes përdorimit të sistemit të "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi", brenda një afati prej 48 orësh;
2. Të hiqet menjëherë kamera që monitoron anën e pasme të godinës të Kontrolluesit dhe në rast se ajo do të vendoset përsëri, të njoftohet Komisioneri me anë të formularit të njoftimit. Kamera të vendoset në mënyrë të tillë që të jetë drejtuar vetëm drejt fasadës së godinës të Kontrolluesit në mënyrë që të mos marrë pamje nga rruga dhe objekti pranë saj;
3. Në zbatim të nenit 18 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" të vendosen tabela për informimin e subjekteve të të dhënave personale që ambienti është i survejuar nga një sistem "Kamera Vëzhgim-Regjistrimi, brenda një afati prej 5 ditësh .
4. Në zbatim të nenit 27 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Mbi sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" të hartohet rregullore për qëllimin, mënyrat e mbledhjes, ruajtjes dhe përpunimit, të të dhënave personale nëpërmjet përdorimit të sistemit të "Kamerave Vëzhgim-Regjistrimi", brenda një afati prej 30 ditësh.
5. Me plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
6. Në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit... "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues,veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij,vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".
7. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

